

0118 2/2472



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

**KOMUNA E PRISHTINËS  
KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale 03/L - 040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, me datën 14 shtator 2015, merr këtë

**V E N D I M**

**I.**

SHKARKOHET Drita Cenaj nga pozita e Drejtores së Shkollës Fillore "Ismail Qemajli".

**II.**

Pozitën e lartcekur do ta mbulojë një ushtrues detyre që do të caktohet me vendim të veçantë.

**III.**

OBLIGOHET Drejtoria e Arsimit ta zbatojë këtë vendim dhe të fillojë procedurat e rekrutimit për pozitën e Drejtorit të Shkollës Fillore "Ismail Qemajli".

**IV.**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes së tij.

**ARSYETIM**

Për shkak të vërejtjeve të njëpasnjëshme që i janë drejtuar Drita Cenajt në lidhje me punën e saj si drejtore e Shkollës Fillore "Ismail Qemajli" dhe rezultateve të dobëta që i ka treguar e njëjta, si dhe në bazë të paragrafit 5, të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2014 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues, Kryetari i Komunës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**I DORËZOHET:**

- Drita Cenajt
- Drejtorisë së Arsimit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë.

**KRYETARI I KOMUNËS**  
**Shpend Ahmeti**



**VENDIM**

I.

II.

III.

IV.

**ANEXE**